

VENDIM
Nr.770, datë 10.11.2011

PËR TRANSFERIMIN E TRUALLIT ME SIPËRFAQE 85 000 M², NË FSHATIN MËZEZ, NË KTHESËN E KAMZËS, TIRANË, NË PRONËSI TË BASHKISË SË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5, 8 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e truallit me sipërfaqe 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) m², me nr.parcele 68, në zonën kadastrale 2 679, në fshatin Mëzez, të regjistruar në vëllimin 4, faqe 161, zona kadastrale 2 697, ndodhur në kthesën e Kamzës, Tiranë, aktualisht në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave, në pronësi të Bashkisë së Tiranës.

2. Çdo procedurë administrative e nisur dhe që ka lidhje me pronën, objekt i këtij vendimi, ndërpritet.

3. Prona është e destinuar të përdoret për ndërtimin e Terminalit Multimodal të Pasagjerëve.

4. Vendimi nr.970, datë 30.9.2009 i Këshillit të Ministrave “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit Ministrisë së Financave, të një sipërfaqeje trualli, në kthesën e Kamzës, Tiranë”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen kryetari i Bashkisë së Tiranës, Ministria e Financave dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha